



**BURIME DHE
INFORMACION PËR
T'JU NDIHMUAR T'I
BËNI BALLË COVID-19**



TESTIM

GJURMIM

PËRKUJDESJE



**VIZITONI [TESTANDTRACE.NYC](https://www.testandtrace.nyc.gov)
PËR MË SHUMË INFORMACION MBI**

- testim për COVID-19
- kohët e pritjes në pikat e testimit
- gjurmimin e kontakteve
- Programin Take Care të Test & Trace Corps

**TELEFONONI NR. 212-COVID19
(212-268-4319)**

Linja telefonike e NYC Test & Trace Corps ofron informacion rreth pikave të testimit, karantinimit, përkrahjes për shëndetin mendor etj.

VAKSINOHUNI!

**VIZITONI [VACCINEFINDER.NYC.GOV](https://www.vaccinefinder.nyc.gov)
OSE TELEFONONI NR. 877-VAX-4NYC
(877-829-4692) PËR TË LËNË NJË
TAKIM.**

Të gjitha moshat e njerëzve nga 16 vjeç e lart që jetojnë, punojnë ose studiojnë në Nju Jork kualifikohen për t'u vaksinuar.

Vaksinat janë **të sigurta, falas dhe të lehta.**



**NDIHMONI
NË NDALIMIN
E PËRHAPJES
SË COVID-19**

- ⊕ TESTOHUNI SHPESH NËSE NUK JENI VAKSINUAR
- ⊕ VEÇOHUNI NËSE NDIHENI TË SËMURË
- ⊕ VAZHDONI TË MBANI MASKË
- ⊕ RUANI 6 FT DISTANCË NGA TË TJERËT
- ⊕ LAJINI DUART SHPESH
- ⊕ SHMANGNI GRUMBULLIMET E MËDHA DHE NË AMBIENTE TË MBYLLURA
- ⊕ VAKSINOHUNI
- ⊕ PËRGJIGJUNI TELEFONATËS NGA GJURMUESI I KONTAKTEVE

NYC



NYC



Albanian_04/21

PËRSE DUHET TË TESTOHENI?

Është e vetmja mënyrë për ta ditur me siguri.

NËSE NUK JENI VAKSINUAR PLOTËSISHT KUNDËR COVID-19, duhet të testoheni shpesh për COVID-19, edhe nëse ndiheni mirë. Nuk është e thënë të keni simptoma të COVID-19 për t'ua ngjitur të tjerëve.

MBANI PARASYSH SE NËSE KENI SIMPTOMA TË GRIPIT APO TË RRFËS, DUHET TË TESTOHENI MENJËHERË EDHE NËSE JENI VAKSINUAR!

Testet janë të sigurta, konfidenciale dhe ju ofrohen pa kosto. Zakonisht rezultatet dalin për 48 orë. Për të gjetur një pikë testimi pranë jush, vizitoni testandtrace.nyc ose telefononi nr. 212-COVID19 (212-268-4319) për më shumë informacion.

ÇFARË DOKUMENTESH MË DUHET TË SJELL PËR TESTIN?

Testimi ofrohet **pa kosto për ju** në të gjitha pikat e NYC Health + Hospitals dhe Sektorit Shëndetësor të NYC, pavarësisht statusit të migrimit. Edhe pse nuk kërkohet, nëse keni sa më poshtë, merrini me vete në ditën e testit tuaj:

- një dokument identifikimi
- një kartë sigurimi (që të mund t'ju faturojmë sigurimet për koston e testit). Testimi është **pa kosto për ju**.

ÇFARË TË BËJ NËSE TESTI MË DEL NEGATIV?

- Zbatoni këto praktika të mira për COVID-19: lani duart shpesh, mbani një maskë, shmangni grumbullimet e mëdha dhe në ambiente të mbyllura, mbani 6ft distancë nga të tjerët dhe nëse filloni të ndiheni i sëmurë, **MOS PRISNI. VEÇOHUNI!**
- Vazhdoni të testoheni shpesh, nëse nuk jeni vaksinuar plotësisht kundër COVID-19.

PO NËSE TESTI IM ËSHTË POZITIV?

PËRGJIGJJUNI TELEFONATËS!

Nëse testi ju rezulton pozitiv, do të merrni një telefonatë nga një contact tracer (gjurmues kontaktesh). Personi do të bashëpunojë me ju për të identifikuar personat që mund të keni ekspozuar. Personi do t'ju ofrojë gjithashtu lidhje drejt burimeve falas.

ÇFARË TË BËJ NËSE NDOKUSH RRETH MEJE MERR COVID-19?

Nëse jeni ekspozuar ndaj COVID-19, **TESTOHUNI** dhe **VEÇOHUNI** menjëherë nga të tjerët. Edhe nëse testin e keni negativ, duhet të vazhdoni me veçimin për 10 ditë nga hera e fundit që jeni ekspozuar ndaj dikujt me COVID-19.

MOS HARRONI, PËRGJIGJJUNI TELEFONATËS NËSE MERRNI NJË TELEFONATË NGA:

- NYC Test & Trace Corps
- NYC COVID Test
- Një numër telefoni që fillon me 212-540-XXXX ose 212-242-XXXX

MOS PRISNI. VEÇOHUNI! PROGRAMI TAKE CARE

Nëse filloni të ndiheni i sëmurë, veçohuni menjëherë. Për t'ju ndihmuar me këtë, **programi Take Care** i NYC Test & Trace Corps do të sigurohet që cilido që teston pozitiv për COVID-19 dhe personat e tij të afërt të kontaktit të kenë burimet e nevojshme për t'ua veçuar në mënyrë të sigurt në shtëpi ose në një dhomë hoteli pa pagesë për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së virusit.

ÇFARË BËJNË GJURMUËSIT E KONTAKTEVE?

ATA JANË NË VIJAT E FRONTIT NË LUFTËN KUNDËR COVID-19

Gjurmuesit e kontakteve janë profesionistë të trajnuar të shëndetit publik që ofrojnë përkrahje për njujorkezët që rezultojnë me test pozitiv për COVID-19 ose që kohët e fundit janë ekspozuar ndaj dikujt me COVID-19. Shumë gjurmues të kontakteve janë nga lagjet e qytetit të Nju-Jorkut që janë prekur më rëndë nga virusi dhe të gjithë janë të përkushtuar në përkrahjen e njujorkezëve dhe ndalimin e përhapjes së COVID-19.

GJURMUËSIT E KONTAKTEVE:

- do të kontaktojnë me individët që kanë rezultuar pozitivë në test ose që janë ekspozuar ndaj COVID-19
- do t'ju bëjnë pyetje për të mësuar se si mund të jeni infektuar dhe për personat e kontaktit që mund të keni ekspozuar
- do t'ju pyesin si ndiheni
- do t'ju ofrojnë lidhje drejt burimeve si p.sh. leje të paguar nga puna, një dhomë hoteli falas etj.

GJURMUËSIT E KONTAKTEVE KURRË NUK:

- do t'ju pyesin për numrin e sigurimeve shoqërore
- do t'ju pyesin për statusin e imigrimit tuaj
- do t'ju pyesin për informacion të natyrës private apo financiare

VERIFIKIMI I GJURMUËSIT TIM:

Si një nivel sigurie shtesë, NYC Test & Trace Corps ofron funksionin "Validate My Contact Tracer (Verifiko gjurmuesin tim të kontakteve)" për të konfirmuar që të flisni me një gjurmues zyrtar kontaktesh të NYC nga Test & Trace Corps. Thjesht vizitoni testandtrace.nyc dhe ndiqni udhëzimet për të konfirmuar gjurmuesin tuaj.

NËSE NDIHENI I SËMURË APO NËSE JENI EKSPOZUAR: MOS PRISNI. VEÇOHUNI!

PROGRAMI TAKE CARE PËRFSHIN:

- një dhomë hoteli të sigurt dhe falas
- ushqim falas (3 vakte në ditë)
- lidhje Wi-Fi falas, televizion kabllor dhe telefonata të pakufizuara lokale
- dërgimin e medikamenteve
- personelin mjekësor në vend

Nëse një hotel nuk është i duhuri për ju, ne mund t'ju ndihmojmë duke ju lidhur me burime të tjera për t'ua veçuar në mënyrë të sigurt në shtëpi. Secili njujorkez kualifikohet, pavarësisht statusit të imigrimit. **Programi Take Care** mund t'ju ndihmojë edhe të merrni leje të paguar nga puna nëse kualifikoheni, që të mos ju duhet të vrisni mendjen për humbjen e punës.

Për më shumë informacion rreth **programit Take Care** të NYC Test & Trace Corps, telefononi nr. 212-COVID19 (212-268-4319) ose vizitoni faqen tonë të internetit te testandtrace.nyc.

